

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Rrustem Thaçi e Burim Shala – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a (PTK) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit A.P nga Prizreni, rr. “...”, nr. ..., për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.748/11, të datës 23.10.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.07.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit A.P nga Prizreni, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.748/11, i datës 23.10.2014, **VËRTETOHET**, përveç pjesës për kamatën e cila **NDRYSHOHET** dhe gjykohet me kamatë sikurse për mjetet e deponuara në bankat komerciale të Kosovës, në afatin mbi një vit, pa destinim të caktuar, e llogaritur nga data 23.10.2014, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.748/11, të datës 23.10.2014, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a, (PTK) me seli në Prishtinë dhe e ka detyruar të paditurin A.P nga Prizreni, që paditësit në emër të borxhit për shfrytëzimin e telefonisë fikse t'ia paguaj shumën e të hollave në vlerë prej 1.042.00 €, me kamatë ligjore 3.5 %, duke iu llogaritur prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Në pikën II të dispozitivit, pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a, me seli në Prishtinë, mbi shumën e aprovuara sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar prej 1.174,08 €, e ka refuzuar si të pabazuar. Në pikën III të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e të

paditurit A.P, ta prishë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.748/11 të datës 23.10.2014, si të pabazuar me ligj, apo që lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosije.

Paditësja nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 20.12.2006, paditësi (ish kreditori) Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar propozim për përmbarim në bazë të dokumentit autentik, kundër të paditurit (ish debitorit), A.P, për shkak të pagesës së borxhit, me arsye sikurse në propozim.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të paditësit (ish kreditorit) me datë 04.01.2007, ka nxjerrë aktvendimin E.nr.94/07, për caktimin e përmbarimit të propozuar.

Kundër aktvendimit për përmbarim E.nr.94/07, të datës 04.01.2007, i padituri (ish debitorit), me datë 07.10.2011, ka parashtruar kundërshtim, duke e atakuar të njëjtin me arsyetimin se borxhi i kërkuar nga kreditori është parashkruar dhe se i njëjti nuk është i bazuar në prova përkatëse ligjore, me propozim që gjykata e shkallës së parë kundërshtimin e tij ta aprovojë dhe që aktvendimin e atakuar ta lë jashtë fuqie, si dhe duke propozuar pezullimin e ekzekutimit të caktuar me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren E.nr.94/07, të datës 04.01.2007.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas kundërshtimit, me datë 17.10.2011,ka nxjerrë konkluzion me të cilën e ka pezulluar procedurën përmbarimore dhe veprimet përmbaruese të aktvendimit E.nr.94/07 të datës 04.01.2007 i ka anuluar, ndërsa propozimin e kreditorit e ka konsideruar padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar tani sipas padisë së paditëses ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit e administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.748/11, të datës 23.10.2014, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata ka arsyetuar se në cilësinë e provave materiale ka administruar kopjet e faturave të muajit Tetor, Nëntor, dhe Dhjetor 2015, sipas të cilave rezulton se janë të lëshuara në emër të A.P., ku ky borxh del të jetë 1.576,34 €, të muajit Janar, Shkurt, Mars, Prill dhe Maj 2016, ku rezulton se borxhi është 1.859,50 €, si dhe kundërshtimin e datës 07.10.2011 të debitorit. Më tutje ka theksuar se në bazë të gjendjes faktike është provuar se i padituri ka detyrime – borxh, ndaj paditëses për periudhën kontestuese. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka theksuar se i padituri nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin kryesor, edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, dhe si rrjedhojë nuk ka ofruar prova që do të kundërshtonin pretendimet e palës paditëse, për çka gjykatës i rezultoj

si i provuar fakti se i padituri i ka borxh paditësit shumë e lartcekur, të cilën edhe e ka obligim që t'ia paguaj.

Sa i përket pjesës refuzuese gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë të parashkuar, pasi që sipas faturës së muajit Tetor 2005 është konstatuar se e njëjta ka arritur për pagesë me datë 25 të muajit për secilin muaj paraprak, ndërsa paditësi (ish kreditori) e ka parashtruar propozimin për ekzekutim me datën 20.12.2006, që do të thotë pas kalimit të afatit një vjeçar brenda të cilit ka qenë i detyruar që i padituri (ish debitori) të paguaj borxhin.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit ka administruar provat e paraqitura nga palët ndërgjyqësore me të cilat ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkuar si në arsyetim të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur dispozitës së nenit 160 paragrafi 4 i LPK-së, në atë mënyrë që ka përshkuar kërkesat e palëve, faktet që kanë parashtruar palët, provat e propozuara dhe të administruara, si dhe mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë së paditëses, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset zyrtarisht, përveq për pjesën e kamatës së gjykuar, për të cilën Gjykata e Apelit gjen se është bërë zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, andaj në këtë pjesë gjykata e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar vetëm sa i përket aplikimit të kamatës, duke e gjykuar kamatën sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit e pa destinim të caktuar, e cila paguhet në bankat komerciale të Kosovës, të llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë, e deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 277 të LMD.

Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm bazuar në dispozitën ligjore të nenit

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të

dispozitive nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e) lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4484/14, me datën 27.07.2018

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj